



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 33**

Datë: 07. 04. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

**Çemailj Kurtişi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së.**

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Çemailj Kurtişi, kryesues i mbledhjes.**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.26 dhe 27/2021.

**2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**3. Aktivitetet e ZRPP-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për dorëzimin e raportit të deklarimit financiar të fushatës së subjektit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për dorëzimin e formularit për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike për vitin 2021.

#### **4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prizren dhe Hani Elezit.

- **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë:**

- Shqyrtim i ftesës të Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të Republikës së Shqipërisë të cilat, do të mbahen më 25 prill, 2021.

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i planifikimit buxhetor për vëzhgimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë.
- Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të derivateve të shpenzuara dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ-së të vitit 2020.

#### **5. Të ndryshme**

---

##### **1. Hyrje: z. Čemailj Kurtiši, anëtar i KQZ-së.**

**Čemailj Kurtiši:** Për shkak të mungesës së kryetares s'i anëtar i KQZ-së në bazë të radhës, do ta kryesoj këtë mbledhje. A dikush vërejtje, propozime...? Nëse jo, kush është për këtë rend dite. Miratohet rendi i ditës...

##### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.26 dhe 27/2021.**

Miratohen me dy vota kundër ( Alim Rama dhe Sami Kurteshi)

### **3. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati, është duke e draftuar raportin e punës së KQZ për vitin 2020, dhe aktivitetet e këtij viti. Sapo të përgatitet, do t'ua përcjellim për miratim. Çështja tjetër: janë asgjësuar materialet e vitit 2007 dhe 2011, dhe materialet e tjera që janë vendosur të asgjësohen. Jemi në proces të kthimit të materialit në QNR.

Jemi po ashtu, tha z. Ahmetaj në proces të realizimit të pagesave të KVV dhe trupave tjerë zgjedhor dhe stafit tjetër të QNR. Aktivitetet të tjera, janë çështja e kthimit të stafit të sekretariatit nga lokacionet që i kemi marrë për procesin zgjedhorë. Besojmë që së shpejti, do të kemi hapësirë në objektin shtesë, këtu ngjitas me KQZ dhe do të zgjerohemi dukshëm në të ardhmen.

Sipas vendimit të Qeverisë të 5 prillit 2021 të , për masat shtesë të covidit, jemi duke e zbatuar këtë vendim dhe po punojmë me staf esencial...

**Čemailj Kurtiši:** Falemnderit kryeshef, ka dikush pyetje ?

**Sami Kurteshi,** kërkoi nga Sekretariati që të kërkohet nga Avokati i popullit për shfrytëzim të sallës për mbledhje për shkak të covidit...

### **4. Aktivitetet e ZRPP-së:**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për dorëzimin e raportit të deklarimit financiar të fushatës së subjektit për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës:**

**Yll Buleshkaj:** Falemnderit kryesues, zyra vazhdon me punët e përditshme që lidhen me subjektet politike, prandaj data 31 marsi ka shënuar dy afate: dorëzimi i raporteve financiare të shpenzimeve që subjektet politike i kanë bërë gjatë fushatës në procesin zgjedhor të 14 shkurtit, dhe afati për dorëzimin e formularit për vazhdimin e regjistrimit. Ky formularë, nënkupton deklarimin e subjekteve politike se, a dëshirojnë të jenë ende në Regjistrin e ZRPP.

Raportet e shpenzimeve, nga 28 subjekte të certifikuara në proces, 27 subjekte kanë sjellë raportet. Një subjekt ka dështuar: SDS. Prandaj, sic e parashih ligji, KQZ është e obliguar t'ia shqiptoj subjektit "Serbski Demokratski Savez" masën prej 1000 euro gjobë. Dhe masën tjetër prej 0.01% të gjobës bazë, për çdo ditë të vonësës së mëtejme deri në dorëzim...

Rekomandojmë që, ky dënim të shqiptohet.

**Arianit Elshani:** Të dy pikat e ZRPP-së janë shqyrtuar edhe në këshillin për çështjet ligjore, dhe ne mbështesim rekomandimet e zyrës...

Në fund, anëtarët e KQZ-së miratuan rekomandimin për shqiptimin e gjobës ndaj subjektit politik SDS.

### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për dorëzimin e formularit për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike për vitin 2021:**

**Yll Buleshkaj:** E keni pranuar një raport lidhur me dorëzimin e e formularit për vazhdimin e regjistrimit të partisë politike për vitin 2021. Kanë sjellë formularin 46 subjekte, por kanë dështuar 2 subjekte në këtë aspekt. Ato që kanë dështuar janë: Partia Demokratike e Diasporës, dhe Alternativa Demokratike e Kosovës. Zyra ka kontaktuar por, këto dy parti nuk janë përgjigjur dhe ne, rekomandojmë largimin e tyre nga regjistri...

Në fund, anëtarët e KQZ-së miratuan edhe këtë rekomandim të ZRPP-së.

## **5. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

#### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës:**

**Arianit Elshani:** Këshilli për Çështje Ligjore i ka shqyrtuar dy kërkesën për kandidatin e radhës për Kuvendin e Kosovës për zëvendësimin e znj. Vjosa Osmani - Sadriu, e cila është zgjedhur Presidente e vendit. Ky zëvendësim, por edhe ato për kuvendet komunale janë konform aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

**Čemailj Kurtiši:** Kush është për që të zëvendësohet znj. Vjosa Osmani - Sadriu, e cila është zgjedhur Presidente e vendit me kandidaten e radhës nga lista e subjektit Lëvizja “Vetëvendosje!”, znj. Yllza Hoti ?

Mriatohet ky rekomandim me vota unanime.

**Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Prizren dhe Hani Elezit:**

**Arianit Elshani:** Këshilli për Çështje Ligjore i ka shqyrtuar edhe dy kërkesa për zëvendësim të anëtarëve të kuvendeve komunale në komunën e Prizrenit dhe në Hanit të Elezit. Për të dy kërkesat, janë shqyrtuar të gjithë filtrat dhe janë në rregull dhe ne, i kemi shqyrtuar me përpikëri prandaj, edhe rekomandojmë të bëhen zëvendësimet.

**Çemailj Kurtişi:** Kush është për që znj. Sabina Dana të e zëvendësojë anëtarin e deritashme të kuvendit komunal në Prizren, Samra Ilijazi e cila, është zgjedhur deputete në Kuvendin e Kosovës. Miratohet.

**Çemailj Kurtişi:** E kemi edhe një zëvendësim! Kush është për që z. Habib Thaci të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Han të Elezit, duke e zëvendësuar z. Hakif Shkreta nga subjekti politik “Vetvendosje!”.

Miratohet.

**Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë:**

**Shqyrtim i ftesës të Komisionit Shtetërorë të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të Republikës së Shqipërisë të cilat, do të mbahen më 25 prill, 2021:**

**Rifat Krasniq:** Në mbledhjen që kemi mbajtur, kemi shqyrtuar kërkesën që KQZ ti vëzhgojë zgjedhjet në Shqipëri për kuvend që mbahen më 24 prill. Po ashtu, kemi shqyrtuar edhe kërkesën e Sekretariatit për një vizitë studimore në Shqipëri. Këshilli, ka miratuar të kërkesa dhe, ne i rekomandojmë KQZ –së me miratimin e tyre.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimet e KMJ-së.

**Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

**Shqyrtimi dhe miratimi i planifikimit buxhetor për vëzhgimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë:**

**Sami Hamiti:** Në mbledhje të buxhetit, kemi shqyrtuar dy pika. Në pikën e parë, ne kemi marr specifikat e shpenzimeve të buxhetit nga Sekretariatit për vëzhgimin e zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë. Kemi diskutuar më gjatë, sepse në këto zgjedhje për herë të parë pilotohen dy projekte elektronike, dhe ne kemi sugjeruar që të miratohet ky buxhet. Konsiderojmë që nuk janë shpenzime të mëdha!

Propozojmë që KQZ-ja ta votojë këtë rekomandim...!

Miratohet unanimisht rekomandimi i Këshillit për Buxhet

**Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të derivateve të shpenzuara dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ-së të vitit 2020:**

**Sami Hamiti:** Për herë të dytë në këshillë, e kemi shqyrtuar raportin e derivateve të shpenzuara dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ-së të vitit 2020. Edhe sipas kërkesave të anëtarëve, është kërkuar që të bëhet një shqyrtim në detaje. Nuk janë të larta shpenzimet, janë në element. Covid, ka ndikuar në rënje pak të shpenzimeve. Por, ende nuk kemi një udhëzimi të ri administrativ që të precizohet saktë se si të shfrytëzohen veturat. Kemi vazhduar me praktikën e vjetra, por është imediate hartimi i një udhëzimi të ri. Me këto informacione, ne rekomandojmë që të aprovohet ky raport.

**Alim Rama:** Raporti është faktik, por kërkoj nga të gjithë respektimin e udhëzimit që është në fuqi. Pra, veturat të përdoren vetëm për shërbime publike, pra të respektohet çdo gjë...

Në fund, anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë raport.

**6. Të ndryshme**

